

ASOCIACIONI RINOR PËR TË DREJTAT E NJERIUT PUBLIKOI RAPORTIN E EFEKTSHMËRISË NË ORGANIN MË TË LARTË KOMUNAL

Debat minimal në Kuvendin Komunal të Lipjanit

Arian Duriqi

LIPJAN, 13 QERSHOR – Monitorimi që po bën shoqëria civile e Lipjanit për Kuvendin Lipjanit nxjerr analizat për rënie të nivelit të diskutimit nga këshilltarët komunalë. Madje këshilltarët nga subjekti i PDK-së, bartëse e pushtetit në Lipjan, sivjet janë me nivel të ulët të pjesëmarrjes në diskutime, krahasuar me po të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Bekim Krasniqi, udhëheqës në Asociacionin Rinor për të Drejtat e Njeriut (YAHR) në bazë të statistikave që ka nxjerrë, ka njoftuar se gjatë periudhës janar – maj 2012 pjesëmarrja në diskutime e këshilltarëve të KK të Lipjanit, lidhur me pikat e rendit të ditës është karakterizuar me ulje krahasuar me vitet e tjera. Ka qenë edhe YAHR-i që ka evidencuar rënie të ritmit në diskutime të këshilltarët e PDK-së. “Anëtarët e PDK-së në KK në këtë periudhë kanë shënuar nivelin më të ulët të pjesëmarrjes në diskutime në katër seancat e mbajtura deri tash nga periudha janar – maj 2012 me 18.07 %, por prapë prijnë në diskutime të përgjithshme të pasuara nga anëtarët e LDK-së me 31.33 %, mirëpo te LDK-ja kemi një ngritje krahasuar me periudhën janar - maj 2011”, ka thënë ai. Nga aspekti individual i pjesëmarrjes në diskutime ndërkaq është partia opozitare ndër më të voglat në KK, ajo e AAK-së që ka dominim. “Është interesante nga aspekti individual i pjesëmarrjes në diskutime se në këtë raport dominojnë partitë më të vogla, sikur AAK-ja, që në foltore për diskutime shpesh ngjitet Sylej-



Bekim Krasniqi, udhëheqës në Asociacionin Rinor për të Drejtat e Njeriut (YAHR), në bazë të statistikave që ka nxjerrë ka njoftuar se gjatë periudhës janar-maj 2012, pjesëmarrja në diskutime e këshilltarëve të KK të Lipjanit lidhur me pikat e rendit të ditës është karakterizuar me ulje krahasuar me vitet e tjera

man Reciça. Po ashtu është interesant edhe fakti se kemi një angazhim të theksuar të disa këshilltareve gra gjatë kësaj periudhe, sepse prijnë në diskutime Mevlide Dulahu nga LDK-ja dhe Mevlide Shamolli nga LDD-ja”, ka thënë Krasniqi.

Ulje të pjesëmarrjes ka edhe në debate, duke i krahasuar me të njëjtën periudhë kohore janar-qershor 2010 dhe janar-qershor 2011. Në vitin 2011 kanë qenë aktivë 25 këshilltarë nga 31 sa ka KK-ja, ose 83.33%, ndërsa në të njëjtën periudhë të këtij viti, 2012, kemi 20 kuvendarë aktivë ose 66.66%, apo dhjetë më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë. Këshilltarët më aktivë kanë qenë

udhëheqësit e grupeve të subjekteve politike në KK, ndërsa ka pasur mjaftueshëm edhe këshilltarë më pasivë, të ashtuquajtur “shikues”, e që janë 10 prej tyre. Shoqëria civile në Lipjan ndërkohë ka rekomanduar këshilltarët komunalë për një angazhim më efikas në mbrojtje dhe në artikullimin e interesave të qytetarëve të komunës së Lipjanit.

Lulzim Rrustemi, kryesues i KK të Lipjanit, po ashtu ka ftuar këshilltarët për diskutime konkrete në pika të rendit të ditës që, sipas tij, kërkojnë më shumë shqyrtim. Ai ka shtuar se pavarësisht se KK-ja nuk e mban një evidencë për numrin e diskutimeve sa ka nga njëri subjekt dhe sa nga tjetri, ka ftuar këshilltarët të jenë më të angazhuar.

Stipe Mesiq d

GJAKOVË, 13 QERSHOR – Stipe Mesiq, do të shpall nderimit për ish-kryetarin e Kur Gjakova kremta të KK të Gjakovës, dëmoninë e nderimit të Shqipërisë Alfred M. ashtu të ftuar janë kryetari i Kuvendit merkurën nga ZIP-i

USAID-

VUSHITRI, 13 QERSHOR – Vushitri, 13 Qershor, siht atyre nga USAID dhënave të pronave Sipas ekspertes ndër USAID-i, programi i nave krijon mundësi munale. “Kemi përshë të dhënave në 140 kadastrale”, ka theks Mulaku, ka falënderu për mbështetjen në risë. “USAID –i është shumë fusha e projel këtë formë komunë munale”, ka deklarua biseduar edhe për ca dhënave nga “data b

Jep do së

RAHOVEC, 13 QERSHOR – Rahevec, 13 Qershor, ditë më parë, të merr ministratës, Lenharç munës së Rahevecit, “Ju konfirmoj se di nga detyra) për arsy gatitjen e tij profesio dhe për këtë arsye do caktuar, por pritet që zyrtar të bëhet emëri elektronike zyrtari p Megjithëse gazeta l përgjigjur as në telef Ndryshe, ekzekutiv

Reka e Keqe

GJAKOVË, 13 QERSHOR

BANORËT E CIRKOLEZIT – PENG I MOSREAGIMIT INSTITUCIONAL

Lagjja Jasharaj, prej 2 vjetësh në pritje të masave kundër rrëshqitjes së dheut